



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 2298 Prot.

Tiranë, më 28.07.2025

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1465/1, DATË 10.06.2025 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASIT, ING. FATMIRA MUSAI, ING. DHAME DAKA, ING. OMER MUSAI, Z. PËRPARIM DARDHA, Z. FLORENC Qafa, Z. FATOS ZOTKA DHE Z. ARBEN Qafa”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga Ing. Fatmira Musai, Ing. Dhame Daka, Ing. Omer Musai, z. Përparim Dardha, z. Florenc Qafa, z. Fatos Zotka dhe z. Arben Qafa nr. 481 prot., datë 07.02.2023, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë së magjistratit R.L. me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastrë, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur, dhe me vendimin 1465/1, datë 10.06.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasit, Ing. Fatmira Musai, Ing. Dhame Daka, Ing. Omer Musai, z. Përparim Dardha, z. Florenc Qafa, z. Fatos Zotka dhe z. Arben Qafa”, bazuar në nenin 120, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh”, nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë të Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Sarandë, sipas adresës së lënë nga ankuesit;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

